

## Nënshtrimi i ndërsjelltë (5:21)

**V**ite më parë, kam dhënë mësimet e Bible. Lënda quhej «Shpjegimi i mësimëve të Biblës». Kjo lëndë i ndihmon nxënësit të kuptojnë mësimet e Biblës dhe si t'i zbatojnë këto mësimet në praktikë. Disa vargje në Bibël nuk duan shumë përpjekje për t'u kuptuar. Për shembull, urdhëri: «Mos vidh» është i thjeshtë. Nuk kemi nevojë të studiojmë lëndën e shpjegimit të Biblës për të kuptuar se çfarë do të thotë ky urdhërim.

Në jetën e përditshme të gjithë interpretojmë gjëra të ndryshme. Disa prej këtyre gjërave janë të thjeshta. Të lexosh një tabelë rrugore që shkruan «STOP» nuk kërkon shumë interpretim. Sapo e shikojmë tabelën, e kuptojmë menjëherë se ç' do të thotë. Në situata të tjera duhet më shumë përpjekje. Leximi dhe kuptimi i një mësimi të fizikës bërthamore do të kërkonte shumë përpjekje.

Le të mendojmë për vargun 5:21. Nuk është një varg i vështirë për t'u kuptuar. Vështirësia nuk qëndron në të kuptuarit e këtij vargu, por në zbatimin e tij.

Ky varg jepet në vazhden e paralajmërimit të Palit për mbushjen me Frymën e Perëndisë. Te vargu 5:18 Pali tha: «Dhe mos u dehni me verë, në të cilën ka shturje, por mbushuni me Frymë.» Pastaj, përshkroi disa nga efektet e të jetuarit të një jete të mbushur me Frymën.

Së pari, jeta e mbushur me Frymën na bën që të kemi bashkësi me njëri-tjetrin dhe t'i flasim njëri-tjetrit me mënyra frymërore. Ndërsa këndojmë, «i

flasim njëri-tjetrit me psalme, himne dhe këngë frymërore» (5:19a). Së dyti, jeta e mbushur me Frymën na bën që t'i këndojmë dhe ta lavdërojmë Perëndinë me zemrën tonë. Së treti, duke qenë të mbushur me Frymën, i jemi mirënjohës Perëndisë dhe e falënderojmë Atë për çdo gjë (5:20). Së katërti, jeta e mbushur me Frymën na bën që t'i «nënshtrohemi njëri-tjetrit në druajtjen e Krishtit» (5:21). Ky varg nuk do shumë për t'u kuptuar.

### **NJË KOMANDË E THJESHTË**

Pali ishte i mendimit se të qenët i mbushur me Frymën na bën që të heqim dorë nga dëshirat tona vetjake për hir të të tjerëve. Fjala greke e përkthyer «nënshtrohuni»<sup>1</sup> ka qenë në fillim një term ushtarak që donte të thoshte «një gradë më poshtë». Kristianët e mbushur me Frymën e radhisin veten një gradë më poshtë se njëri-tjetri. Ata zgjedhin që të mos veprojnë për të arritur gjithmonë atë që duan në mënyrë egoiste.

Të gjithë e dimë se çfarë do të thotë kjo. Por, vështirësia e kësaj qëndron në atë se si do ta vendosim këtë në praktikë. Dhe kjo vështirësi vjen si pasojë e asaj se ne jetojmë në një botë që vazhdimisht na vendos në kokë idenë se duhet të këmbëngulim për të drejtat tona. Na thuhet të marrim gjithçka që mundemi para se dikush tjetër ta marrë atë.

Unë nuk jam rritur në fshat, por dikush prej jush ndoshta është rritur. Në qoftë se keni pasur pula, atëherë e dini se ekziston një hierarki midis pulave

në kotec. Pula me rangun më të lartë mund të çukisë këdo pa u shqetësuar për pasojat. Pula me rangun më të ulët nuk mund të çukitë asnjë pa pasur pasoja të rënda. Të gjitha pulat janë të vendosura sipas një hierarkie midis pulës superiore dhe pulës me rangun më të ulët. Në qoftë se hedhim misër midis dy pulave, atëherë pula me ragun më të lartë do të hajë misrin. Në qoftë se tjetra përpiqet ta marrë atë, fillon lufta. Kur luftimi mbaron, pula fituese mban të njëjtin rang ose vendoset një rang më lart.

Ajo që ndodh midis pulave në kotec, ndodh edhe midis njerëzve në jetën e përditshme. Më kujtohet njëherë se ekipi i futbollit në qytetin tim mori një trajner të ri dhe të gjithë ndihmës trajnerat filluan të ndërhyjnë për të zënë vendin e ndihmës trajnerit kryesor. E njëjta gjë ndodh në vendin e punës, në shkollë, etj. Njerëzit përpiqen të ndërhyjnë e të bëjnë matrapazllëqe për të zënë një vend me përgjegjësi në mënyrë që të jenë në poste drejtuese e të veprojnë sipas mënyrës së tyre.

Pali do që të kuptojmë se kristianët zgjedhin që të mos jetojnë në atë mënyrë. Ne nuk bëjmë hile e manovra për t'i bërë gjërat në mënyrën që duam. Kristianët nuk e luajnë këtë lloj loje. Dy nga dishepujt e Jezusit u përpoqën njëherë të luanin këtë lojë:

Atëherë Jakobi dhe Gjoni, bij të Zebedeut, iu afruan dhe i thanë: «Mësues, ne dëshirojmë që ti të bësh për ne atë që do të të kërkojmë». Dhe ai u tha atyre: «Çfarë doni të bëj për ju?» Ata i thanë: «Na lejo që të ulemi njëri në të djathtën tënde dhe tjetri në të majtën tënde në lavdinë tënde» (Marku 10:35–37).

Jakobi dhe Gjoni donin që të dilnin mbi të tjerët. Ata donin që të radhiteshin më lart se të tjerët në mbretërinë e ardhshme. Ata donin gjithçka që mund të kishin. Jezusit iu desh t'u tregonte një mënyrë tjetër të jetuarit:

Ju e dini që ata që konsiderohen sundues të kombeve i sundojnë ato dhe të mëdhenjtë e tyre ushtrojnë mbi to pushtetin e tyre; por kjo s'duhet të ndodhë midis jush; madje ai nga ju që do të dojë të bëhet i madh, do të jetë shërbëtori juaj; dhe kushdo nga ju që do të jetë i pari, do të jetë skllavi i të gjithëve. Sepse edhe Biri i njeriut nuk erdhi që t'i shërbejë, por për të shërbyer dhe për të dhënë jetën e tij si çmim për shpëngimin e shumë vetave (Marku 10:42b–45).

Jezusi u tha atyre: «Nuk është kjo mënyra se si veprojmë në mbretërinë. Kjo ishte mënyra e të vepruarit në të kaluarën, por mbretëria është ndryshe. Në mbretërinë e Perëndisë është më mirë të japësh se sa të marrësh.»

Njerëzit, që janë të mbushur me Frymën, nuk

këmbëngulin që të veprojnë sipas mënyrës së tyre. Ata në fillim shikojnë interesin e të tjerëve. Ata «i nënshtrohen njëri-tjetrit».

Lexoni përsëri vargun 5:21. Vini re arsyen e thjeshtë për nënshttrimin e ndërsjellë: «në druajtjen e Krishtit». Fjalë për fjalë kjo do të thotë «të kesh frikë nga Krishti». Fjala greke për «druajtje» është *fóbos*. Druajtja është më shumë se respekt. Solomoni tha: «Ki frikë nga Perëndia dhe respekto urdhërimet e tij, sepse kjo është tërësia e njeriut» (Predikuesit 12:13b). Të kesh frikë nga Perëndia do të thotë *ta marrësh Atë seriozisht, me gjithë mend*. Kjo do të thotë të marrim parasysht se kush është Perëndia dhe kush jemi ne dhe si pasojë të biem në gjuhë përpara Tij. Pali, me fjalë të tjera, po na thoshte: «Ju tregoni se e merrni Krishtin me gjithë mend, kur i nënshtroheni njëri-tjetrit.»

Është e nevojshme që të mbajmë një qëndrim nënshttrimi në të gjitha marrëdhëniet me të tjerët. A jeni shërbëtorë në shtëpinë tuaj? A mendojnë njerëzit me të cilët punoni apo shkoni në shkollë se jeni njerëz jepni bujarisht e me gëzim, pa prituri që të merrni ndonjë gjë si këmbim? Po në kishën ku shkoni? A shkoni në kishë sepse doni të përfitoni diçka? A i merrni në konsideratë nevojat, shqetësimet dhe ndjenjat e kristianëve të tjerë?

Kisha është vendi ku mësojmë si t'i nënshtrohemi njëri-tjetrit. Perëndia sjell së bashku në kishë njerëz të të gjithë llojeve. Ne mësojmë të respektojmë dhe të nderojmë njëri-tjetrin. Qëndrimi më i keq që mund të sjellim në kishë është ideja e botës se «Më mirë të veprojmë sipas mënyrës sime, se përndryshe nuk do të jem i lumtur». Kjo ide nuk gjendet në mësimet dhe jetën e Krishtit.

## NJË SHPJEGIM VETJAK

Shpjegimi më i mirë i vargut 5:21 gjendet të Filipianëve 2. Pali e shkroi letrën drejtuar Filipianëve pothuajse në të njëjtën kohë që shkroi edhe letrën drejtuar Efesianëve. Me sa duket, kisha e viteve të para kishte probleme, ashtu si edhe ne, me marrëdhëniet midis anëtarëve të saj. Ndoshta disa prej anëtarëve gjithmonë prisnin të merrnin nga të tjerët, në vend që të kërkonin mundësitë për të dhënë më shumë. Në lidhje me këtë, Pali shkroi:

Mos bëni asgjë për rivalitet as për mendjemadhësi, por me përlësi, secili ta çmojë tjetrin më shumë se vetveten. Mos mendojë secili për interesin e vet, por edhe atë të të tjerëve (Filipianëve 2:3–4).

Në vargjet e mësipërme përshkruhet koncepti i

nënshtrimit ndaj njëri-tjetrit. Tani, vini re arësyen se pse duhet t'i nënshtrohemi njëri-tjetrit. Ka të bëjë me Krishtin.

Kini në ju po atë ndjenjë që ishte në Jezu Krishtin, i cili, edhe pse ishte në trajtë Perëndie, nuk e çmoi si një gjë ku të mbahej fort për të qenë barabar me Perëndinë, por e zbrazi veten e tij, duke marrë trajtë shërbëtori, e u bë i ngjashëm me njerëzit; dhe duke u gjetur nga pamja e jashtme posi njeri, e përluli vetveten duke u bërë i bindur deri në vdekje, deri në vdekje të kryqit. Prandaj edhe Perëndia e lartësoi madhërisht dhe i dha një emër që është përmbi çdo emër, që në emër të Jezusit të përkulet çdo gju i krijesave (ose gjërave) qiellore, tokësore dhe nëntokësore, dhe çdo gjuhë të rrëfejë se Jezu Krishti është Zot, për lavdi të Perëndisë At (Filipianëve 2:5-11).

Nënshtrimi i ndërsjelltë vjen si pasojë e të qenit i përlulur. Jezusi na tregoi se ç' do të thotë të jesh i përlulur. Është shenja që tregon se jeta jonë është e mbushur me Frymën. Marrëdhëniet tona me njerëzit e tjerë kurrë nuk do të jenë ashtu si kërkon Perëndia, në qoftë se nuk jemi të përlulur. Duke qenë të përlulur sigurohemi që jemi në rrugën e duhur. Përlulësia na ruan nga kokëfortësia krenare për t'i thënë jo çdo lloj ndryshimi, ajo na ruan nga të qenët mendjekyllur. Përlulësia na bën që të jemi të ndjeshëm ndaj ndjenjave të të tjerëve. Ajo na ndihmon që të jemi të duruar ndaj dobësive të të tjerëve dhe na çliron nga mënyrat tona për të parë vetëm interesin vetjak. Përlulësia na jep mundësinë që të jemi të hapur dhe jo të mbyllur me njëri-tjetrin.

Ajo na bën që t'i shikojmë të tjerët me një frymë hiri në vend që të shikojmë çdo të metë e dobësi në ta. Përlulësia na nxit që të kërkojmë më të mirën te të tjerët dhe na mban larg nga hamendjet, thasethemet dhe mashtrimet për të zënë një post të ri. Përlulësia është nënshtrimi ndaj njëri-tjetrit, për shkak të respektit që kemi për Krishtin.

Duhet ta shfaqim përlulësinë në shtëpi, në marrëdhëniet e përditshme me njerëzit si dhe në kishë.

## NJË SHQYRTIM PRAKTIK

«Nënshtrojuni njëri-tjetrit në druajtjen e Krishtit» (5:21). Duket e thjeshtë apo jo? Është më e lehtë ta kuptosh këtë varg se sa ta zbatosh në praktikë. Le të shqyrtojmë tri ide të cilat mund të na ndihmojnë për ta zbatuar këtë çdo ditë.

Autor: Rusty Peterman  
Marrë nga seria: "Efesianëve"

1. *Vini re se dëshira për të vepruar ashtu si ju thotë mendja juaj nuk është gjë tjetër veçse mënyra në të cilën vepron gjithë bota. Ky lloj qëndrimi është në kundërshtim me mësimet e Jezusit.* Ndoshta e justifikojmë dëshirën për të vepruar sipas mënyrës sonë, duke pretenduar, me naivitetet, se nuk e dimë që kështu po i mbyllim derën zbatimit të vullnetit të Perëndisë në jetën tonë.


2. *Filloni çdo marrëdhënie duke bërë këtë pyetje: «Çfarë dëshiron t'i japë Jezusi këtij personi nëpërmjet meje?»*

3. *Lutjuni Perëndisë çdo ditë në këtë mënyrë: «Më trego, o Perëndi, se ku nuk u nënshtrohem të tjerëve në mënyrën që do Ti.»* Lejojeni Jezusin që t'ju ndihmojë të shikoni se ku keni nevojë të bëni ndryshime dhe përmirësime në marrëdhëniet tuaja me njerëzit e tjerë.

## KONKLuzion

Marrëdhëniet jonë me Perëndinë në jetë është ajo që kemi me Perëndinë. Duhet të kemi frikë nga Perëndia dhe të zbatojmë urdhërimet e Tij. Perëndia ka thënë për Jezusin: «Ky është Biri im; dëgjojeni Atë.» Perëndia do që ta dëgjojmë dhe t'i bindemi Jezusit. Asnjë nga marrëdhëniet e tjera në jetën tonë nuk do të jetë ashtu si duhet, në qoftë se nuk jetojmë sipas mënyrës së treguar nga Jezusi.

Pranojeni Jezusin në jetën tuaj. Ai ofron faljen e mëkateve dhe një fillim të ri të jetës. Dëgjojeni Atë dhe binduni Fjalës së Tij. Jezusi tha: «Ai që beson dhe është pagëzuar do të jetë i shpëtuar» (Marku 16:15-16). A i jeni bindur urdhërimit të Tij?

Megjithëse jeni kristianë, pasi lexoni vargun 21 mund të vini re se nuk keni treguar respektin dhe nderimin e duhur për Krishtin. Ndoshta keni këmbëngulur që të bëhet ashtu si thoni ju, pa u shqetësuar për të tjerët. E gjithë kjo është një betejë. Të gjithë luftojmë me egoizmin. Kërkojini Perëndisë në lutjet tuaja që t'ju forcojë në luftën tuaj kundër egoizmit. «Nënshtrojuni njëri-tjetrit në druajtjen e Krishtit.» Kjo ndodh kur mbusheni me Frymën e Shenjtë. 

## SHËNIME

<sup>1</sup>Fjala greke në fushën ushtarake i referohej nënshtrimit ndaj një oficeri epror. Kjo fjalë përdorej gjithashtu edhe në lidhje me skllëvërit dhe zotërinjtë. Fjala do të thotë të heqësh dorë nga e drejta apo dëshira jote vetjake.

© 2003 E VERTETA PER SOT  
Të gjitha të drejtat të rezervuara